

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kryeqyteti nuk mund t'ua japë lirinë, por mund t'i nderojë"/ 'Qytetar Nderi' për liderët e UÇK-së, Veliaj ia propozon nga burgu këshillit bashkiak të Tiranës
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/19/kryeqyteti-nuk-mund-tua-jape-lirine-por-mund-ti-nderoj-e-qytetar-nderi-per-lideret-e-uck-se-veliaj-ia-proponon-nga-burgu-keshillit-bashkiak-te-t/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:12:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 12:07:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 12:06:00 UTC → 19 shtator 2026, 12:08:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	342d20c61e1856b413124fede584c43b98989c9d10f957aefae4ea7c58ec8d60
TEKSTI	8809e78e3110dae92b540e9adc2ba65d510d5bbc55cf5a6427e3a086b3f53cd0
PAMJA	5c4a6127ccb44b39c100f78b633ef0a7efab4ee19ab1d5913c8bb434d8569cc1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80ecab9e5d4f2a47cf458253e58375854b9d53a7fa05b2c74af76025dd920b84
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80ecab9e5d4f2a47cf458253e58375854b9d53a7fa05b2c74af76025dd920b84>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

“Kryeqyteti nuk mund t’ua japë lirinë, por mund t’i nderojë”/ ‘Qytetar Nderi’ për liderët e UÇK-së, Veliaj ia propozon nga burgu këshillit bashkiak të Tiranës

19/09/2026 14:07



Në një deklaratë nga paraburgimi, kryebashkiaku i Tiranës thotë se vendimi i Hagës ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së e ka tronditur thellë, ndërsa thekson se procesi juridik duhet të ndjekë rrugën e tij.

Sipas Veliajt, nderimi nga Tirana nuk synon të zëvendësojë drejtësinë me politikën apo t’i tregojë gjykatës se çfarë duhet të vendosë, por të shprehë, siç thotë ai, mirënjohjen për kontributin historik të katër ish-drejtesve të UÇK-së në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë.

Veliaj u bën thirrje edhe kryetarëve dhe këshillave bashkiakë të qyteteve të tjera shqiptare që të ndërmarrin nisma të ngjashme. Në deklaratë, ai ndalet edhe te situata e tij personale, duke thënë se prej 19 muajsh ndodhet në izolim dhe pa mundësi reale për të ushtruar mandatin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Por, sipas Veliajt, çështja e Kosovës dhe kujtesa për luftën e saj për liri janë më të mëdha se drama e tij personale. “Tirana fatkeqësisht nuk mund t’ua japë dot lirinë. Por Tirana duhet t’i nderojë ata”, shprehet Veliaj, duke e mbyllur deklaratën me mesazhin se Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi duhet të jenë, sipas tij, nderi i kryeqytetit.

Deklarata e plotë e Veliajt:

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

të dashur qytetarë të Tiranës,

të dashur shqiptarë kudo që jeni,

Po bëj 19 muaj në izolim. Nëntëmbëdhjetë muaj pa mundësinë reale për të ushtruar mandatinkushtetues që më kanë besuar qytetarët e Tiranës me një rekord historik votash.

Vetëm pak ditë më parë u mor një tjetër vendim gjyqësor që ishte një grusht institucional ndaj demokracisë vendore. Natyrshëm, mund të prisnit që sot t’ju flisja për këtë.

Por ka momente në jetën e një njeriu kur drama e tij personale bëhet e vogël, përpara një çështjeje kombëtare.

Vendimi i dhënë në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit më ka tronditur thellë. Sigurisht procesi juridik ka rrugën e vet dhe drejtësia duhet të ndjekë deri në fund procedurat dhe standardet e saj. Por ne shqiptarët kemi edhe përgjegjësinë për të kujtuar.

Për të kujtuar si liria e Kosovës erdhi pas dekadash represioni, dhimbjeje dhe rezistence,

I Kryesore



“Prania Besnike”, zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle

08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze

08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

11:11

I Më të lexuarat

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratiset

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur

JPMorgan: Nuk e dimë se si do të përfundojë lufta SHBA-Iran/ Analistët për “The Guardian”: Tregu është në ankth për çmimin e naftës

“Më kërcënuan se do të më vrisnin nënën”/ Brëfimi tronditës i artistes ruse pas

pas familjesh te debuara nga shtepite e tyre, jetesh te humbura dhe sakrificash te jashtëzakonshme, pas vendimit të një populli për të mos pranuar më që fati i tij të përcaktohet nga të tjerët. Në atë histori, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka vendin e saj të lavdishëm, sikurse ushtarët e saj Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Ata janë katër burra që historia i vendosi në një prej kapitujve më të vështirë dhe më vendimtarë të Kosovës. Kam jetuar dhe punuar në Kosovë, e njoh nga afër Hashimin ...

Ndaj sot dua që Tirana të flasë. Tirana nuk është vetëm kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, por kryeqendra e shqiptarisë. Për këtë arsye, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, do t'i propozoj Këshillit Bashkiak që: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi të shpallen Qytetarë Nderi të Tiranës.

Sigurisht jo për ta zëvendësuar drejtësinë me politikën. Jo për t'i treguar një gjykatë se çfarë duhet të vendosë. Por për të ushtruar të drejtën e qytetit tonë për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e vet për kontributin e tyre historik në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe shtetësisë.

Tirana fatkeqësisht nuk mund t'ua japë dot lirinë. Por Tirana duhet t'i nderojë ata.

E nga Tirana dua t'u drejtohem edhe kryetarëve dhe këshillave bashkiakë të qyteteve të tjera shqiptare, të nderojnë si Tirana. Pasi këta katër burra nuk janë pjesë vetëm e historisë së një qyteti. Ata janë pjesë e historisë së Kosovës dhe përmes saj, e historisë sonë shqiptare. Le t'u tregojmë familjeve të tyre se nuk janë vetëm. Le t'u tregojmë shqiptarëve të Kosovës se Shqipëria nuk e harron Kosovën. Le t'u tregojmë brezave që vijnë se një shoqëri mund të respektojë drejtësinë dhe njëkohësisht, të ruajë kujtesën e vet historike.

Prandaj sot, nga vendi ku ndodhem, dua t'u them Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit: Procesi juaj juridik do të vazhdojë. Drejtësia do të ndjekë rrugën e saj. Por edhe kujtesa jonë do të ndjekë të vetën. Nuk do ta harrojmë Kosovën e represionit dhe të dëbimeve. Nuk do t'i harrojmë ata që humbën jetën. Nuk do t'i harrojmë familjet që sakrifkuan gjithçka dhe nuk do ta harrojmë kontributin e atyre që morën përgjegjësi në luftë dhe më pas në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Unë mund të jem sot pas një dere të mbyllur, por pikërisht këtu kam kuptuar edhe më mirë diçka shumë të thjeshtë: liria është një nga ato fjalë, peshën e plotë të së cilës e kupton edhe më fort kur të mungon. Ndoshta prandaj sot e ndiej Kosovën edhe më afër. Sepse historia e saj na kujton se liria nuk bëhet e përjetshme vetëm sepse është fituar një herë. Ajo ruhet. Mbrohet. Kujtohet. Nderohet.

Për ata që nuk arritën ta shihnin ditën e saj. Për familjet që paguan çmimin e saj. Për të gjithë ata që luftuan dhe punuan për të. Për Kosovën. Për lirinë. Për kujtesën tonë kombëtare. Ata duhet dhe do jenë nderi i kryeqytetit tonë, Tiranës.

Erion Veliaj

Kryetar i Bashkisë së Tiranës

Top Channel

arratisjes nga vendi: U detyrova që të merrja pjesë në ekzekutimin e...

I Aktualitet »



Aksident në Fier-Patos,
motoristi i picave mbetet i plagosur pasi u përplas nga një automjet

19/09 13:02



Foto/ Vrau gruan me thikë
brenda në banesë,
vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimin në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur

19/09 12:59



Prokuroria e Fierit godet skemën e dyshuar të pronave në
Levan, 2 arrestime dhe qindra mijëra euro të sekuestruara

19/09 12:35





Dyshohen për përvetësimin e 1143 hektarëve tokë përmes dokumenteve të falsifikuara, ish-drejtnesit e ASHK-së në Fier dalin para gjykatës

19/09 12:14



Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

19/09 12:08



Incident me armë zjarri në Tiranë, plagoset lehtë një person. Shpallet në kërkim autori i dyshuar

19/09 11:56

I Kryesore »



"Shëndetësinë e mori në dorë vetë Rama"/ Ndryshimet në ministri, Berisha: Demo i gatuar me bandat, ka lidhje të afërta me kreun e SPAK

19/09 13:54



Trajneri Maran e la jashtë listës, Jasir Asani nuk e fsheh pakënaqësinë: Historia nuk harrohet kurrë

19/09 13:35



"Qytetarët duhet ta dinë se Balluku është bashkë-autore në të gjitha vjedhjet"/ Berisha: Kur SPAK kërkoi për herë të parë arrestimin e saj...

19/09 13:27



Rama vizitë disaditore në SHBA, Kryeministri merr pjesë në Asambleshë e Përgjithshme të OKB-së

19/09 13:03



Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur

19/09 12:59



FSHF refuzon kërkesën e Tiranës, ndeshja ndaj Elbasanit do të luhet pa tifozë në stadium

19/09 12:58

Na ndiqni:



I Video »



Top News- Ekstremistët e Afd i shtrijnë dorën Putin/ Tronditet Gjermania, gazit rus drejt rikthimit




Top News- Gjermania forcon flotën ajrore/ Merr avionin e parë F-35 nga SHBA



Top News- Broja e Bajrami jashtë...Maran shpjegon zgjedhjet: Ja pse nuk i thirra



Top News- Trump rrit presionin ndaj Putin/ Miratohet projektligji, sanksione më të ashpra ndaj Rusisë



Top News- Nations League, Broja e Bajrami jashtë/ Risitë e kombëtares, Maran shpall listën



Top News- Shqipëria drejt hapësirës/ I bashkohet marrëveshjeve ndërkombëtare të Artemis

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Përputhen	Topin e kam unë – Aplikoj tanil!
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Kontakt
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.